



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për diskutimin e projektligjit “Për rininë” me aktorë të interesit (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhembulla, Bujar Çela, Adelina Rista, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Klajdi Qama.

Mungojnë:

Eneda Kapllani.

Të ftuar:

Kristi Trako- përfaqësues i studentëve të Universitetit të Mjekësisë,
Klea Zylfi- përfaqësuese e studentëve të Universitetit të Mjekësisë,
Erjon Bala- përfaqësues i studentëve të Universitetit të Mjekësisë,
Linda Pino- përfaqësuese e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri,
Ervjola Osmanaj- përfaqësuese e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri,
Artemisa Aliaj- përfaqësuese e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri,
Vojsava Firi - përfaqësuese e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri,
Klaudio Pulaha- përfaqësues i Qendrës të së Drejtave të Fëmijëve, përfaqësues të CRCA/ECPAT Shqipëri,

Benson Begaj - përfaqësues i Qendrës të së Drejtave të Fëmijëve, përfaqësues të CRCA/ECPAT Shqipëri,

Zamira Gjini – drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Erzen Tola – drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve,

Florian Nurçe - përgjegjës i Sektorit të Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve,

Matilda Bulku – specialiste në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri - Përshëndetje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së këtij komisioni!

Sot në rendin e ditës kemi seancën dëgjimore me aktorë të interesit për diskutimin e projektligjit “Për Rininë”.

Të ftuar nga grupet e interesit janë: Kristi Trako, Klea Zylfi, Erjon Bala, përfaqësues të studentëve të Universitetit të Mjekësisë; Linda Pino, Eryjola Osmanaj, Artemisa Aliaj, Vojsava Firi, përfaqësues të Koalicionit për Arsimin në Shqipëri; Klaudio Pulaha, Benson Begaj, Qendra e të Drejtave të Fëmijëve, përfaqësues të CRCA/ECPAT, Shqipëri; Zamira Gjini, drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Erzen Tola, drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator; Florian Nurçe, përgjegjës i sektorit të Buxhetit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; Matilda Bulku, specialiste në sektorin e Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Me sa duket, një pjesë e të ftuarve nuk kanë ardhur.

Fillojmë me seancën dëgjimore. Secili nga aktorët e interesit ka një minutazh të caktuar në këtë seancë dëgjimore, e cila do të jetë 10 minuta.

Fillojmë me grupin e interesit, përfaqësues të studentëve të Universitetit të Mjekësisë. Cili nga ju do ta marrë fjalën?

Erjon Bala- Përshëndetje!

Ju falënderoj për ftesën për sa i përket këtij grupimi interesi. Unë quhem Erjon Bala, anëtar i senatit akademik, përfaqësues i studentëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Kam kaluar të gjithë projektligjin për të parë pikat dhe nenet dhe nuk shoh ndonjë cenim të madh për sa u përket politikave në interes të rinisë, sepse normalisht këto grupe kontrolli, për mendimin tim, duhet të kenë edhe një pikë bazë nga të cilat kontrollohen. Unë e kuptoj që ne të rinjtë duam që t’i marrim gjërat në dorë vetë, por e dimë që në Shqipëri ndodh pa dashje, ndonjëherë edhe me dashje, që t’i cenojmë interesat tona brendapërbrenda, kur nuk kemi pika kontrolli mbi kokë. Në qoftë se ne krahasojmë rininë tonë me atë europiane, ata funksionojnë ndryshe dhe qasjet i shohin më ndryshe se tonat. Ndoshta shumë nga të rinjtë

nuk janë dakord me fjalën time dhe mund të thonë që kam mendim tjetër nga ata, por e mendoj sinqerisht se, në qoftë se nuk do të ketë një ministër apo zëvendësministër, ose një kryetar bashkie ose këshill bashkiak mbi këto këshilla rinorë për sa u përket fondeve...., sepse kur flasim për fonde në Shqipëri, vazhdohet për gjëra të tjera. Prandaj mendoj se do të ishte mirë që këto këshilla rinorë të zgjidhen brenda vetes, zgjedhjet të jenë transparente dhe publike, ku propozimet të bëhen shumë ditë më parë dhe të hapen konkurse, ashtu siç funksionin për zgjedhjet në universitete dhe për zgjedhjet e këshillave studentorë. Pra, këshillat rinorë duhet të kenë faqe, ku mund të bëjnë publike të gjitha shpenzimet e tyre ditore dhe shpenzimet për projektbuxhetet që ato marrin për përfitimet, për bursat e të tjerë, në mënyrë që këto këshilla të jenë në interes të rinisë. Besoj se te pjesa e financimit duhet të jetë pasqyra e pastër në kuptimin e harxhimit të fondeve. Fondet merren nga projektet e buxheteve të bashkive vendore, të qeverisjes e të tjerë dhe duhet të jenë të pasqyruara se si këta këshilla rinorë i shpenzojnë këto të ardhura dhe për çfarë i përdorin. Kjo është ideja. Nuk kam gjë tjetër për sa i përket projektligjit. Të tjerat më duken gjëra të qarta që mund realizohen. Suksese në vazhdim!

Kristi Trako - Jam Kristi Trako, kryetar i këshillit studentor të Fakultetit të Mjekësisë. Në projektligjin që lexova dje disa pika që unë nuk arrij t'i perceptoj deri në fund dhe që dua një shpjegim më shumë lidhen me Autoritetin Kombëtar Rinor. Pyetja ime është: pse lind nevoja që në çdo hallkë, ministritë apo personat brenda linjave institucionale të drejtojnë apo të kenë një peshë thuajse përcaktuese në mënyrën se si do të hartohen politikat apo se si do të administrohen pikat kyçe në proces? Pse të rinjtë nuk e kanë aftësinë të vetorganizohen në këtë nivel dhe lind nevoja që patjetër të jetë një numër i përcaktuar i fuqisë që kalon nga pushteti vendor apo qendror?

Fatjona Dhimitri- Faleminderit!

Pyetjes suaj mund t'i përgjigjet një nga ekspertët e ministrisë.

Erzen Tola- Përsëritje!

Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, të nderuar anëtarë!

Lidhur me pyetjen e zotit Trako, dua t'ju sqaroj se në projektligj janë tri shtylla strukturash: në shtyllën e parë është vendosur institucioni përgjegjës për rininë, i cili është institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit; institucioni që është sot është parashikuar të funksionojë përsëri në këtë projektligj dhe strukturat në nivel vendor, të cilat do të jenë pranë bashkive, përsëri si sisteme përgjegjëse, që do të merren me të gjithë veprimtarinë rinore.

Lidhur me këshillin kombëtar dhe atë rajonal, ato janë organe konsultative pranë ministrit dhe kryetarëve të bashkive. Asnjë veprimtari e organizatave rinore nuk mund të kontrollohet, sepse organizatat rinore organizohen dhe funksionojnë sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse dhe asnjë organ shtetëror, i përcaktuar në këtë projektligj, nuk mund të kontrollojë apo të ndërhyjë në veprimtarinë e organizatave rinore.

Zamira Gjini- Përsëndetje!

Jam Zamira Gjini. Pyetjet e studentëve ne, si Ministri e Arsimit, sigurisht që do t'i shohim dhe do t'i vlerësojmë. Ndoshta mënyra se si ne e kemi shprehur veprimtarinë e këtyre organizatave në ligj ka dhënë këtë efekt tek të rinjtë, të cilëve u krijohet përshtypja sikur çdo gjë do të kontrollohet nga ministria. Ne, sigurisht, mund t'i rishohim edhe një herë këto formulime dhe këto përkufizime, në mënyrë që edhe të rinjtë të marrin përgjigje, për të cilën janë ende të paqartë.

Fatjona Dhimitri – Kush e do fjalën?

Linda Pino – Përsëndetje të gjithëve!

Unë jam Linda Pino, përfaqësuese e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri. Shumë faleminderit për ftesën dhe prezencën e të dyja krahëve, pozitës dhe opozitës, për të shqyrtuar këtë ligj kaq të rëndësishëm për rininë sot. Them se është i rëndësishëm, sepse rinia prej kohësh ka kërkuar të ketë një ligj të tillë, por, kur me *email* vjen një ligj i hartuar në këtë formë, atëherë lindin dyshime, sepse shumë gjëra që rinia ka nevojë, nuk janë të adresuara në këtë ligj.

Në radhë të parë, nuk është adresuar puna me dinjitet për të rinjtë, nuk janë të adresuara çështjet sociale se si do t'i mbulojë ky ligj, por e vetmja gjë që ky ligj përmend dhe e kanë trumbetuar deri më sot është pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje. Për çfarë vendimmarrjeje bëhet fjalë, për vendimmarrje politike? A është kjo gjëja më emergjente që ka rinia sot?!

Duke parë ligjin për të rinjtë në Shqipëri, mua më lindi një pyetje: ku është bazuar ky ligj? A është bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë? A është bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, të cilën parlamenti i Shqipërisë e ka si udhërrëfyesin e vet për të shkuar drejt Bashkimit Europian? Pasi jemi ulur me një grup nga CRCA, nga Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë, kemi parë që ky ligj ka shkelur disa nga nenet e Kushtetutës dhe shprehimisht, ka shkelur nenin 15 të Kushtetutës, duke kufizuar të drejtat e të rinjve për të garantuar që ky nen, që ka vendosur një pjesë të të rinjve në pozita të pabarabarta, sepse ka disa mekanizma, të cilat janë përmendur në këtë ligj, që i shikojnë disa të nënës dhe disa të njerzës rininë shqiptare. Neni 16 i Kushtetutës garanton të drejtat e shtetasve shqiptarë, të

shtetasve të huaj apo atyre pa shtetësi, duke bërë kështu shkeljen e Konventës së Këshillit të Europës për shtetësinë, të cilën edhe shteti shqiptar e ka miratuar.

Gjithashtu, është neni 18 i Kushtetutës, i cili është shkelur. Po ashtu, kemi nenin 22 të Kushtetutës, i cili garanton lirinë e shprehjes për çdo të ri në mbarë Shqipërinë. Edhe ky nen është shkelur pikërisht në pikën, ku thuhet: “Të rinjtë do të jenë nën tutelën e kryetarëve të bashkisë”, duke i bërë ata pjesë integrale të tyre. Unë nuk po i hyj nen për nen se çfarë ka ky ligj, sepse do të jenë kolegët e mi që do ta trajtojnë më shumë.

Gjithashtu, kemi edhe nenin 46 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e organizimit, e cila shkelet të paktën haptazi në 3 nene të kësaj Kushtetute.

Po vazhdoj pak me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, në shtyllën për fuqizimin e rinisë në mënyrë të qëndrueshëm, numri 4 dhe 6, shprehimisht thuhet: “Është ngritur Këshilli Kombëtar për Rininë dhe kjo do të jepte shpresë që të na integronte në Bashkimin Europian dhe do t’i shikonte të rinjtë shqiptar në mënyrë më europiane.” Por, me një të rënë të lapsit, ky ligj për rininë sot e ka shpërbërë SHKR-në dhe nuk dimë se çfarë do të bëjë me këtë Këshill Kombëtar për Rininë.

Shërbimi Kombëtar për Rininë, si një sërë detyrash të tjera, ka pasur monitorimin apo edhe zbatimin e Planit Kombëtar për Rininë. Por me Planin Kombëtar për Rininë çfarë do të bëhet, nëse do ta zhbëjmë këtë si institucion?

Një tjetër pikë ka të bëjë me Planin e Integritimit Europian 2016-2020, që është një ndër dy dokumentet kryesore përbërëse të SKZHI-së. Atje thuhet që *acquis*-ja e Bashkimit Europian në fushën e lëvizjes së punëtorëve bazohet në parimet e përgjithshme, që rrjedhin nga traktati mbi Bashkimin Europian dhe traktati për funksionimin e Bashkimit Europian. Është e drejtë që ne kemi disa ligje për sa i përket punësimit, që e përafrojnë legjislacionin tonë me atë të Bashkimit Europian, por shprehimisht te ky ligj, përveç pjesëmarrjes së vendimmarrjes, nuk shprehet asgjë se si do të trajtohen me dinjitet punonjësit në Republikën e Shqipërisë; se si do të trajtohen me dinjitate ata të rinj të kthyer nga emigracioni; se si do të trajtohen me dinjitet të rinj që duan të investojnë në Shqipëri apo dhe të rinjtë pa shtetësi, apo edhe të huajt që vijnë dhe investojnë. Atëherë, nëse do ta shikojmë në prizmin e relacionet për projektligjin për rininë, këtu thuhet: “Projektligji për rininë është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave”. Mos është gjë në përputhje me “Paktin për universitetin” dhe hajde po e kalojmë një ligj të tillë?! Kjo është pyetja që ne bëjmë. Ky ligj për rininë duhet të jetë në përputhje me ato strategji kombëtare, të cilat parlamenti shqiptar i ka aprovuar.

Së fundi, për ta mbyllur këtu fjalën time, u drejtohem të gjitha anëtarëve të këtij komisioni: për të bërë diçka të mirë, duhet ulur dhe duhet të punohet së bashku me rininë dhe jo vetëm me një pjesë të rinisë, jo vetëm me një kah të rinisë, sepse ka shumë të rinj që e kanë kundërshtuar këtë ligj, por nuk janë dëgjuar.

Pyetja e fundit: a do të dëshironin këtu anëtarët e komisionit që të shkohet me një ligj të çorganizuar? A do të ishte në etikën e këtij komisioni të thuhet: “Po, ky ligj është shumë i mirë”? Atëherë, do të ishte një humbje për të gjithë ne, si pjesë e rinisë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Në lidhje me pyetjet e parashtruara nga grupet e interesit, mund të përgjigjet eksperti i ministrisë.

Erzen Tola – Në lidhje me pyetjet, ashtu siç u shpreh edhe zonja Gjini, ne po i mbajmë shënim të gjitha, sepse nuk mendojmë se duhet ta kalojmë në debat kushtetues nen për nen dhe të gjitha nenet, ku pretendohet që është shkelur Kushtetuta. Ne do t'i mbajmë shënim dhe do të kthejmë përgjigje për secilën nga këto.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesi i CRCA/ECPAT-së.

Klaudio Pulaha – Përshëndetje të gjithëve!

Përshëndetje, zonja kryetare!

Së pari, ju falënderoj që keni hapur për diskutim dhe keni ftuar grupet e interesit të shoqërisë civile, grupime rinore, sepse është shumë e nevojshme që të dëgjohen! E theksoj që ka qenë në mungesë dëgjimi i organizatave rinore, rrjeteve rinore në Shqipëri për sa i përket...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Për procedurë, e ndërpres vazhdimin e kësaj fjalie, sepse ju nuk keni të drejtë të thoni që në këtë komision nuk jeni thirrur në seanca dëgjimore. Nuk është e vërtetë, sepse në seanca dëgjimore jeni thirrur shpesh, dhe fakti që jeni thirrur këtu është vendim i këtij komisioni dhe këtë gjë duhet ta thoni pikërisht kështu, ju lutem!

Më falni, në qoftë se ju keqkuptova, por duhet ta dini!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në këtë komision jeni thirrur për çdo gjë dhe ky komision vazhdimisht merr vendime për t'ju thirrur e dëgjuar juve.

Fatjona Dhimitri – Mund të vazhdoni, zoti Pulaha!

Klaudio Pulaha – Korrigjoj veten, në qoftë se jam kuptuar gabim.

Për sa i përket projektligjit të rinisë, përkundrazi, unë ju falënderoj sepse jeni Komisioni i Edukimit dhe i Informimit Publik, dhe na keni ftuar për të diskutuar. Ky ishte përgëzim dhe jo kritikë. Faleminderit, sepse është e nevojshme!

Që t'u rikthehem disa prej çështjeve më shqetësuese të të rinjve, që kanë të bëjnë me projektligjin e rinisë, dua ta nis nga një pike, për të cilën u fol pak më parë, për sa u përket këtyre këshillave vendore. Në qoftë se i referoheni nenit 10 të projektligjit "Për Rininë", që është hartuar nga qeveria shqiptare, tekstualisht thuhet: "Këshillat vendore të rinisë do të krijohen dhe funksionojnë pranë kryetarit të bashkisë", pra, as pranë bashkisë si institucion, as pranë si këshill bashkiak, por do të ngrihen pranë kryetarit të bashkisë. Ajo çka po kërkohet, dhe shpresoj të kuptohet edhe nga të gjithë ju deputetët, sepse e theksoj jeni në krah të të rinjve dhe jam i sigurt për këtë pjesë, nuk mundet që një këshill rinor vendor, që do të bëjë bashkë organizata rinore, rrjete rinore, të rinj dhe studentë të krijohet pranë këtij kryetari bashkie. Pse? Hajdeni ta krijojmë pranë këtij institucioni. Institucioni është bashkia X, 61 bashki. Domethënë, a është e mundur që ta ndryshojmë? Nga ana tjetër, si është e mundur që kryetari i Këshillit Rinor Vendor të jetë kryetari i bashkisë apo kryetarja e bashkisë? Nuk mundet. Mendoj se ju e besoni dhe e pranoni që rinia nuk mundet të drejtohet nga kryetarët e bashkive. Jemi këtu për t'ju shtrirë dorën për bashkëpunim. Hajdeni ta ndryshojmë, sepse është në dëm të nxitjes së përfshirjes së të rinjve në vendimmarrje. Dua të jem i qartë dhe t'i vendosim të gjitha pikat mbi "i" për sa u përket të gjitha neneve që na shqetësojnë.

Në qoftë se i referohemi një neni tjetër, për sa i përket projektligjit të rinisë, në nenin 8 thuhet: "Institucionet përgjegjëse për rininë" dhe në asnjë moment nuk është specifikuar dhe nuk thuhet se cili do të jetë ky institucion përgjegjës. Unë jam dakord që Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të dojë që ta rregullojë masën ligjore, por një projektligj i mirë është i mirë dhe cilësor në atë moment kur është i qartë. Meraku ynë si organizata apo si të rinj është nëse institucioni që është duke hartuar këtë projektligj, me ato akte nënligjore, do të shkojë drejt rezultateve që do të arrijë. Kështu që është shumë e rëndësishme edhe ajo që ne po kërkojmë. Hajdeni t'i qartësojmë të gjitha nenet, të cilat janë përfshirë në këtë projektligj. Në qoftë se i referohemi një neni, për shembull, neni 13 në këtë projektligj, theksohet që ministria, ministri i Rinisë, do të përzgjedhë organizatën rinore kombëtare, që do të përfaqësojë të rinjtë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe do të jetë një organizatë rrjet këshillimor pranë kësaj ministrie.

Më falni, si është e mundur, që, së pari, të përzgjidhet vetëm një organizatë apo rrjet; së dyti, pse duhet ta përzgjedhë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë këtë pjesë?! Nuk

mund ta zgjedhin vetë të rinjtë se kush është zëri më i qartë, i hapur dhe transparent për sa u përket të rinjve?

Nga ana tjetër, për sa ai përket këtij projektligji, në nenin 13 thuhet: “Organizatave ose rrjeti rinor që do të përzgjidhet, do të përzgjidhet vetëm në bazë të numrit më të lartë të organizatave apo grupimeve që do të kenë pjesë”. Ajo që na shqetëson më shumë është: si është e mundur që një përzgjedhje të një organizate, organizatave rinore apo rrjeti rinor, nuk e bëjnë bazuar në punën dhe në rezultatet konkrete, që në njëfarë mënyre të nxisim punën e të rinjve në Shqipëri dhe të mos nxisim mendimin se nëse ti ke mik, nëse ti ke njohje në institucion, atëherë ti do të përzgjidhesh?! E theksoj, se numri që është vendosur si kriter nuk është funksional për ta përzgjedhur. Pse? E dimë shumë mirë që kemi mijëra organizata në Shqipëri, janë thjesht një emër, thjesht në letër me një emër në *facebook* dhe nuk bëjnë asgjë për të rinjtë. Jemi këtu të nxisim meritokracinë dhe ashtu siç ju e keni trumbetuar në çdo seancë, hajdeni t’i ndihmojmë të rinjtë! Jemi këtu t’i ndihmojmë të rinjtë, jo të jemi në kundërshtim me njëri-tjetrin, sepse nuk është ky qëllimi ynë. Ne duam që ky projektligj të jetë për të rinjtë dhe jo për institucione apo grupe të tjera të interesit.

Për sa i përket pjesës së organizimit që projektligji i bën rinisë apo strukturës, nëse i referohemi kreut II, e para e punës e kemi të paqartë, sepse nuk ka një përkufizim se çfarë është. Fillon thjesht me një rrjet rinor dhe, nga ana tjetër, nuk e dimë nëse kreu II ka të bëjë me mekanizmat institucionale në bazë të të cilëve do të organizohet rinia shqiptare, por thuhet: “Rrjeti rinor”. Jam i sigurt se e keni lexuar me kujdes. Aty nuk saktësohet asgjë se për çfarë do të jetë ky rrjet rinor, por thuhet: “Këshilli Kombëtar i Rinisë”. Më vonë thuhet se do të përzgjidhen kaq e aq organizata e të tjera, por nuk e kemi të qartë sa do të përzgjidhen dhe kush do t’i përzgjedhë. Mbi çfarë bazë kriteresh do të përzgjidhen? Duhet të bëhen të qarta, sepse rinia shqiptare realisht është lodhur deri më sot për sa i përket mungesës së transparencës në përzgjedhje.

Nëse i referohemi një përkufizimi tjetër, që është një organizatë rinore, e para e punës shkel Kushtetutën, por është shkelur edhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, sepse aty thuhet se organizata rinore duhet të ketë në përbërje 70% të rinj. Ne jemi shumë dakord të vendoset një kriter që drejtuesi të jetë rinor, por nuk mund të më detyrosh që organizata rinore të jetë e përbërë me 70% apo 80% të rinj. Mund të jetë bordi që të ketë këtë përqindje, por nuk mundet të më kërkohet përbërja e organizatës me 70 - 80%, sepse si qeveri më hyn në rregullim privat. Deri në rregullimin e sferës publike ne jemi dakord, ju na keni ndihmuar, por në momentin që i hyjmë kontrollit të organizatave rinore dhe atyre të shoqërisë civile, lind problemi. Prandaj ne po ngremë zërin.

Që të mos fokusohem vetëm te përkufizimi apo strukturimi, ajo që na shqetëson më tepër nuk janë thjesht këto nene, që janë përfshirë, por ka edhe shumë nene të tjera, që nuk janë përfshirë. E kemi kërkuar gjithmonë me ngulm, besoj se edhe për ju është bërë e lodhshme: Karta Rinore apo Karta e Studentit. Nga viti 2004-2005 ka qenë premtim elektoral dhe sot e kësaj dite kemi mbi 681 mijë të rinj në të gjithë Shqipërinë që ende nuk marrin shërbime cilësore, që mund të ofrohen nga Karta Rinore apo Karta e Studentit. Kanë qenë diskutime të hershme që me Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe Rininë, ku i hidhej topi Ministrisë së Arsimit: “Shikojeni, se e keni kartën e studentit në nenin 100 të ligjit “Për arsimin e lartë””. Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit po shikon kompetencat, nëse do të jetë në kompetencë të pushtetit lokal ofrimi i Kartës së Studentit.

E theksoj, se jam shumë dakord që janë ndarë 20 mijë Karta Studenti në Tiranë, por pyetja ime është se çfarë po bëhet me studentët dhe të rinjtë që janë në 6 qytete të tjera universitare në Shqipëri? Në momentin që marr Kartën e Studentit në Tiranë, pasi jam student në Tiranë, a do të më njihet nga Bashkia e Korçës, meqenëse kam lindur dhe jam rritur atje dhe shkoj të takoj familjen? Është një pikëpyetje e madhe. Nga ana tjetër, si është mundur që përjashtohen nga këto shërbime gjimnazistët apo të rinjtë, të cilët nuk kanë pasur mundësi të vazhdojnë studimet e larta, pasi edhe ata janë të rinj, kanë nevojë për shërbime cilësore dhe miqësore nga shteti ynë? Ajo që po kërkojmë është: pse nuk është përfshirë në projektligjin “Për rininë” kjo pikë, sepse deri dje thuhej: “Nuk ka një bazë ligjore, që ne ta ofrojmë!”? Tani kur ne po kërkojmë që ky projektligj për rininë të jetë funksional, në këto momente ne themi e heqim këtë Kartë Rinore dhe i harrojmë 681 mijë të rinj në mbarë vendin.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm, që të mos u rikthehemi përsëri protestave të dhjetorit, siç ishte protesta e studentëve, që është për t’u përgëzuar, studentët dhe shumë të rinj, në momentin kur askush nuk i doli në krah mbrojtjes së të drejtave të tyre, kanë kërkuar ngritjen e një komisioneri, saktësisht siç është Avokati i Popullit, një institucion i pavarur. Pra, të ketë një komisioner për të drejtat e të rinjve, që të mund të mbrojnë të drejtat e të rinjve kudo ku ndodhen. Nuk është përfshirë. Kolegia ime e theksoi pak më parë në Shërbimin Kombëtar të Rinisë. Pra, kemi institucionet përgjegjëse, atëherë pse nuk e specifikon këtë strukturë? Çfarë do të bëjë ministria përgjegjëse? Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë po e harton këtë projekt, por nëse shikoni nenet përkatëse, ia heq kompetencën e hartimit të ligjeve, thjesht thotë: “Harton politika dhe programe rinore”, por nuk e thekson në asnjë moment se mund të ndërmarrë një nismë ligjore, siç po ndërmerret projektligji “Për rininë”.

Një pikë tjetër shumë interesante është pjesa që ky projektligj shprehet për të rinjtë e diasporës. Nëse i referohemi këtij projekti, vetëm një fjalë është: “të rinjtë e diasporës” dhe në asnjë moment nuk shpjegohet se çfarë roli duhet të kenë të rinjtë e diasporës. Në asnjë moment nuk shpjegohet se çfarë do t’u ofrojnë të rinjve të diasporës dhe të rinjve shqiptarë që jetojnë në shtetin tonë. Është shumë e rëndësishme që të mos fusim thjesht fjalë, por t’i sqarojmë, të shpjegojmë se çfarë duhet. Si është e mundur që nuk janë marrë parasysh të rinjtë, të cilët janë pa shtetësi dhe të rinjtë që kanë shtetësi të huaj në Shqipëri? Përse nuk i përfshin këta të rinj që jetojnë në vendin tonë?

Nga ana tjetër, jam shumë dakord që ka një vendim të Këshillit të Ministrave për nxitjen e punësimit të të rinjve, por si është e mundur që nuk është menduar për 30% të të rinjve që janë të papunë dhe zëmë aktualisht ndër vendet e para në Europë për papunësinë e të rinjve? Nuk mendojnë seriozisht që nëpërmjet këtyre projektligjeve, specifikisht projektligjit “Për rininë” të mund ta rregullonim këtë plagë të shoqërisë shqiptare? Nuk e shikojmë në asnjë moment punësimin dinjitoz të të rinjve, por nxisim akoma dhe më tepër që t’u referohemi *call center*-ave, pavarësisht se kemi mbaruar studimet me rezultate maksimale. Nëpërmjet këtij projektligji duhet të mendojmë për të rinjtë, kjo është shumë e rëndësishme.

Ju shtrijmë dorën, pasi neve si të rinj nuk na intereson nëse jeni deputetë të pozitës apo të opozitës, ju lutem bëhuni bashkë për të ndryshuar nenet, të cilët kanë nevojë për t’u ndryshuar!

Mos lejoni që nesër të rinjtë, të cilët na ndjekin, të vënë gishtin, së pari mbi mua që jam një përfaqësues i tyre; e dyta, ta vënë tek të gjithë ju, deputetët, sepse në njëfarë mënyrë kanë shpresë të qëndrojnë në Shqipëri dhe jo të rritet më tepër numri 80% i të rinjve që duan të largohen.

Hajdeni t’i mbajmë të rinjtë këtu, t’u japim shërbime konkrete, që të mos bëjmë sikur po punojmë! Çfarë na tremb që ta ndryshojmë këtë projektligj dhe të vendosim pikat mbi “i”, për sa u përket neneve? Të jetë në dorën e të rinjve edhe ky projektligj.

E fundit, zonja kryetare, përpara një muaji kemi qenë në konsultimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022 në Ministrinë e Arsimit. Ajo që na shqetëson dhe realisht e kemi adresuar, është fakti që këtu thuhet buxhet për rininë, por a e dini ju se në këtë projektbuxhet afatmesëm për rininë të Ministria e Arsimit nuk ka asnjë shifër konkrete se si do të zbatohet ky projektligj dhe nga do t’i marrë fondet? Unë jam shumë dakord se ka donatorë, siç është përfshirë në projektligj, por donatorët sot i kemi, nesër na lënë në baltë.

A është e mundur që shteti shqiptar të mendojë seriozisht për sa i përket investimit për të rinjtë?

Faleminderit që kishit dëshirën e mirë që më dëgjuat! Ju lutem, para se të votoni, merrni në konsideratë edhe problematikat e të rinjve!

Fatjona Dhimitri – Po, zonja Ekonomi.

Milva Ekonomi - Ju falënderoj shumë për këtë prezantim, por dua t'ju them vetëm diçka për një gjë që është shumë e rëndësishme. Kushtetuta thotë se të drejtën për të propozuar projektligje e kanë: Këshilli i Ministrave, çdo deputet dhe 20 mijë zgjedhës. Në këtë projektligj nuk mund të ketë vend nisma e Këshillit Rinor si nisëm ligjore dhe nuk mund ta marrë parasysh ky projektligj. Ju keni shumë të drejtë për shumë gjëra, por kjo gjë është kushtetuese dhe nuk mund ta vendosni në projektligj.

Sa për informacionin tuaj, nuk mund ta kërkonim këtë formulimin e këtij neni, sepse është Kushtetuta ajo që na jep kuadrin ligjor për të ndërmarrë nisma ligjor në Republikën e Shqipërisë. Sa për gjërat e tjera, kam përshtypjen se të gjithë ne i morëm shënim. Mbase, zonja kryetare, duhet të kërkonim që të na i depozitojnë me shkrim të gjitha gjërat, sepse vërejtjet ishin shumë të mira.

Fatjona Dhimitri – Pasi të mbarojë seanca dëgjimore, do ta parashtroj kërkesën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, urdhëroni!

Adelina Rista – Ju falënderoj për gjithçka që thatë. Ne na shërben dëgjesa, sepse sa më shumë dëgjojmë, aq më tepër mendime tërheqim dhe bëjmë ligje të mira.

Për t'u qartësuar për veten time, mbase s'e dëgjova mirë unë, por më duket se u përsërit disa herë: kartë rinore dhe kartë studenti. E kërkonim disa herë këtë dhe i mëshoni fort. Në konceptin tim, kartë rinore është një gjë, përfshin një grup të gjerë shoqëror, siç janë të rinjtë, ndërsa kartë studenti është krejt gjë tjetër, sepse përfshin ata që quhen studentë. Jo të gjithë të rinjtë janë studentë. Ju e thatë disa herë: s'keni bërë kartën rinore, s'keni bërë kartën e studentit.

Tani, edhe ju vetë duhet të jeni të qartë në lidhje me çfarë kërkonim. Kërkonim kartën e studentit apo kërkonim kartë rinore? Sepse nuk janë e njëjta gjë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Po, po, urdhëroni!

Klaudio Pulaha– Ju falënderoj së tepërmi për pyetjen. Është shumë e nevojshme të qartësohet edhe për gjithë të rinjtë që po na ndjekin. Jemi shumë të qartë se çfarë është karta rinore dhe çfarë është karta e studentit. Ne, si rrjet kombëtar për të rinjtë në Shqipëri, prej

vitesh kemi kërkuar që karta e studentit të mund të integrohej dhe të mund të ofrohej një kartë rinore. Jam shumë dakord që karta e studentit është për studentët, por ne kemi edhe mbi njëqind e ca mijë gjimnazistë në Shqipëri, të cilët ndjekin studimet. Është shumë e nevojshme që edhe për ata gjimnazistë, të cilët mund të studiojnë larg familjeve të tyre, që mund të jetojnë nëpër konvikte e të tjera, t'u ofrohen shërbime nëpërmjet kësaj karte rinore.

E theksoj: që në fillim, nga të gjitha qeveritë që kanë qenë, është kërkuar karta e studentit. Ne kemi lobuar dhe kemi avokuar që kjo gamë dhe kjo sferë të mund të zgjerohej e të përfshiheshin edhe të rinj të cilët, jo domosdoshmërisht janë studentë dhe jo domosdoshmërisht kanë pasur mundësinë të jenë studentë. Kjo do të thotë se, në qoftë se është e mundur, nëpërmjet bashkëpunimeve të ndryshme dhe memorandumëve të bashkëpunimit që Ministria e Arsimit, por edhe qeveria shqiptare, edhe bashkitë mund të kenë me biznese të ndryshme, pse të mos i përfshijmë edhe të rinjtë që s'janë studentë? Kemi 35 % të popullsisë shqiptare. Le t'i fuqizojmë me shërbime. Nuk na kushton asgjë. Përkundrazi, do të ishte nxitje edhe për zhvillimin e bizneseve.

Ju falënderoj shumë!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Përfaqësuesi i Shoqatës Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë. Ka të pranishëm? Jo!

Përfaqësuesi i lëvizjes rinore egjiptiano-rome. Ka të pranishëm? Jo!

Përfaqësuesi i Akademisë së Studimeve Politike ka kthyer përgjigje me shkrim. I ka paraqitur propozimet me shkrim.

Atëherë, lidhur me pyetjet e parashtruara nga grupet e interesit, a do të përgjigjen ekspertët e ministrisë?

Erzen Tola – Siç u shprehëm edhe më parë, janë bërë shumë pyetje. Nëse do të na paraqiteshin me shkrim, do të ishin shumë më të qarta për t'u trajtuar e për t'u kthyer përgjigje.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, grupet e interesit, ju lutem: të gjitha pyetjet apo diskutimet tuaja, t'i paraqisni me shkrim pranë sekretarisë së komisionit, pranë ekspertëve të ministrisë, për të marrë një përgjigje sa më efikase.

Duke qenë se për herë të parë në Shqipëri hartohet një projektligj që prek rininë shqiptare, do të kërkoja mirëkuptim edhe nga pala e maxhorancës ose, më mire, do të paraqisja një propozim për ngritjen e një grupi pune në komision, ku të mund të draftohen nene në të mirë të rinisë shqiptare. Pra, unë do të kërkoja kohë për ngritjen e këtij grupi pune me përfaqësues të maxhorancës, opozitës dhe shoqërisë civile, për draftimin e projektligjit.

Nuk e di nëse pala e maxhorancës do të ishte dakord.

Milva Ekonomi – A mund ta marr pak fjalën për procedurë?

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni!

Milva Ekonomi – Zonja kryetare, gjërat që ndodhin në komision janë të tilla: paraqitet një projektligj që vjen nga qeveria. Pasi vjen projektligji dhe bëjmë diskutimin në parim, ne thërrasim grupet e interesit. Në këtë rast, grupet e interesit kanë sjellë disa komente, si dhe kanë sjellë disa sugjerime, të cilat janë shumë thelbësore për projektligjin. Ndërkohë, që të vazhdojmë diskutimet nen për nen, ne kemi nevojë që në lidhje me gjithë këto sugjerime, Komisioni i Ligjeve të japë një gjykim. Mbasi Komisioni i Ligjeve të japë një gjykim, ne duhet të marrim një vendim. Vendimi do të jetë: do të shikojmë këto nene që na kanë ardhur apo do ta rikthejmë ligjin për t'u punuar nga e para. Kështu, në këtë moment, ngritja e grupit të punës është vendim i mirë, por do marrë kohë për t'u realizuar, sepse ne presim vendimin e Komisionit të Ligjeve. Ata kanë dhënë opinione lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit. Në këtë rast, ligji ka nevojë për ripunim. Unë besoj se në këtë moment është e parakohshme të flitet për grup pune. Është e udhës të presim gjykimin e Komisionit të Ligjeve e pastaj të shohim se çfarë do të ndodhë me projektligjin: ta vazhdojmë punën në komision apo ta rikthejmë për ripunim?

Fatjona Dhimitri – Ka propozime të tjera?

Do të ishte mirë që sot të ishin të pranishëm edhe grupe të tjera të interesit. Përsëri po kërkoj mendimin e maxhorancës, nëse mund të kemi seancë tjetër dëgjimore, në të cilën të mund të thërrasim edhe grupet e tjera të interesit, pasi, siç e thashë, për herë të parë kemi një projektligj kaq të rëndësishëm, që prek rininë shqiptare.

Fidel Ylli – Tani, pak a shumë, kryetarja bëri një rezymë të projektligjit. Projektligji ka nevojë për rishikim. Të gjitha amendimet që kanë sjellë grupet e interesit, ne duhet t'i marrim në konsideratë. Rinia është pjesë shumë e rëndësishme, ndaj ne nuk duhet t'i lëmë këto problematika kur të ngrihen studentët, por duhet të ulemi që sot, me shumë qetësi e maturi, ta rregullojmë këtë ligj dhe t'i marrim në konsideratë të gjitha këto. Siç e tha edhe Milva, Komisioni i Ligjeve duhet të shprehet për anën ligjore, kushtetutshmërinë, pastaj të vijë këtu te ne, të ngremë grupin e punës. Nëse ky ligj do të shtyhet për një periudhë tjetër, nga shtatori, mendoj se do t'i shërbejë punës.

Fatjona Dhimitri – Dakordësohem me mendimin tuaj!

Ka diçka tjetër?

Milva Ekonomi – Për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Po.

Milva Ekonomi – Për ta sjellë në vëmendje, të gjithë ramë dakord si komision, që në këtë seancë dëgjimore do të kishim të gjitha organizatat që kishin bërë kërkesë për të ardhur këtu. Të mos harrojmë se CRCA-ja e ka bërë kërkesën me të dëgjuar se projektligji do të vinte për t'u diskutuar në Kuvend, e madje ka sjellë edhe materiale me shkrim.

Fatjona Dhimitri – Po.

Milva Ekonomi – Ka qenë e para që ka sjellë materiale me shkrim. Pasi morëm një vendim për t'i thirrur në këtë komision, u bëmë një kërkesë të gjitha organizatave. Pjesëmarrja këtu është me organizatat që i janë përgjigjur vendimit tonë. Është shumë e rëndësishme të themi se i kemi thirrur të gjithë ata që kanë pasur interes për të marrë pjesë në diskutim. E para kjo.

E dyta, mendoj se në lidhje me të gjitha diskutimet, edhe ato që vijnë nga komisionet e tjera, se ne jemi komision përgjegjës, por ka edhe tre komisione të tjera që e shqyrtojnë këtë projektligj: Komisioni i Integritit, Komisioni i Çështjeve Sociale e Shëndetësisë, si dhe Komisioni i Ligjeve, nëse ky projektligj është konform normave, nëse është i mirë në disa nene, ka nevojë të përmirësohet në ndonjë nen, ka nevojë për përpunim, vendimi i takon këtij komisioni. Komisioni, pasi dëgjon opinionet e shoqërisë civile dhe të tjerëve që janë të interesuar, pret opinionet e tre komisioneve.

Kështu, unë them se në këtë moment duhet të pyesim sekretarinë nëse janë depozituar të tre mendimet e komisioneve, unë nuk e di nëse kanë ardhur të tria, e më pas të vendosim çfarë do të bëjmë në lidhje me këtë gjë.

Ndërkohë, kam përshtypjen se të gjitha materialet me shkrim të shoqërisë civile, janë depozituar. Dikush edhe mund të mos i ketë pasur me vete, por ndërkohë ka folur para mikrofonëve dhe duke folur para mikrofonëve, procesverbalizohet i gjithi, shkruhet, zbardhet dhe ne mund ta kemi në dorë për të punuar. A mundet dikush nga sekretaria të na ndihmojë?

Sekretarja – Komisioni i Integritit dhe Komisioni i Shëndetësisë i kanë paraqitur raportet e tyre. Presim raportin e Komisionit të Ligjeve, që ende nuk ka ardhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Muhamet Bela – Në lidhje me shoqatat dhe grupet e interesit që përmendët, ata janë njoftuar, siç e tha edhe deputetja. Edhe Universiteti i Tiranës është njoftuar, Universiteti Politeknik i Tiranës është njoftuar, edhe shoqata egjiptiane është njoftuar, edhe shoqata e jetimëve, edhe Akademia e Studimeve Politike.

Fatjona Dhimitri – Mendoj se për një arsye apo për një tjetër, ndoshta nuk kanë pasur mundësi të jenë sot.

Muhamet Bela – Unë nuk vendos, por komisioni. Unë po them se çfarë është bërë.

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni!

Ervina Osmanaj – Unë bashkohem me çdo problematikë dhe çdo shqetësim të ngritur nga kolegët e mi që lidhet me ligjin.

Kam një kërkesë të fundit, ju lutem, merrni në konsideratë të gjitha problematikat që ka ligji dhe mos e çoni në parlament në datën 11 korrik. Është shumë e nevojshme të punojmë së bashku për të bërë një ligj me efekte pozitive për të rinjtë dhe të kontribuojmë në përmirësimin e situatës për të rinjtë në Shqipëri.

Faleminderit për ftesën!

Faleminderit që dëgjuat opinionet tona!

Fatjona Dhimitri – Përpara se të mbyllim mbledhjen, a ka diçka për të shtuar?

Po.

Almira Xhembulla– Si relatore e projektligjit, dua të sjell në vëmendje se që në krye të herës, në momentin kur e kaluam projektligjin në parim, e kemi diskutuar edhe me ministrinë që, pasi të dëgjojmë grupet e interesit, do të jemi të kujdesshëm për të përfshirë mendimet, sugjerimet dhe rekomandimet e adresuara në komision. Prandaj më vjen mirë për krijimin e kësaj hapësirë dhe kohe, për marrjen në konsideratë të mendimeve, disa prej të cilave ne i dëgjuam sot.

Falënderoj komisionin për dhënien e kohës, në mënyrë që të kemi një produkt final sa më gjithëpërfshirës dhe një projektligj ashtu siç e duan të rinjtë, sepse është për ata.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Siç e thamë edhe më lart, për të pasur një ligj të mirë, duhet të presim mendimin e Komisionit të Ligjeve dhe reflektimin për dhënien e përgjigjeve nga ekspertët e ministries, për sa u përket pyetjeve apo diskutimeve të grupeve të interesit. Pra, kërkohet më tepër kohë për shqyrtimin e këtij projektligji.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Milva Ekonomi – Grupet e interesit thanë se projektligji ka probleme kushtetutshmërie. Përpara se të vija në mbledhje, takova nënkryetarin e Komisionit të Ligjeve për ta pyetur për projektligjin, por ata sot do ta shikonin. Ata kanë kërkuar kohë për shikimin e tij. Pra, komentet që kanë ardhur a janë në linjë me komentet e komisionit? Ky projektligj nuk do të kalojë menjëherë, por do të marrë kohën e nevojshme, në mënyrë që të jemi seriozë kur të miratojmë projektligjin.

E dyta, ne kemi kandidaturat e për Këshillin Drejtues të RTSH-së, prandaj duhet të vendosim për kalendarin, por duhet të kemi parasysh se më 18 korrik kemi seancën parlamentare.

E treta, ka ardhur një kërkesë për dëgjese nga Shoqata e Botuesve. Unë mendoj se kur t'i thërrasim në dëgjese, përpara datës 18 korrik, duhet të ftojme edhe përfaqësues nga Ministria e Financave, si dhe përfaqësues nga Ministria e Kulturës.

Të kalojmë te projektligji “Për Akademinë e Shkencave”, për të cilin kemi miratuar kalendarin e dëgjesave. Prandaj të mos harrojmë se pjesë e dëgjesës do të jenë akademitë, dhe ajo e Albanologjisë, universitetet dhe ministria.

E dyta, për këtë projektligj ka ardhur një përgjigje nga Këshilli i Ministrave, e cila na ndihmon në shqyrtimin nën për nën të tij.

E treta, përveç nismës së depozituar nga deputetët, kemi edhe komente që kanë ardhur nga persona të tjerë të pavarur, për shembull Aurela Anastasi ka depozituar në sekretari komente për këtë projektligj. Pra, të gjitha komentet që kanë ardhur për këtë projektligj, si nga Këshilli i Ministrave dhe të atyre që do të vijnë nga dëgjesat dhe njerëzit e pavarur, do t'i përmbledhim në një tabelë matrice, siç i bëjmë zakonisht. Unë mendoj se grupi i këshilltarëve tanë me relatorin, por edhe me anëtarë të tjerë të komisionit, kush ka dëshirë, të punojnë së bashku me nenin që është propozuar dhe me gjitha komentet që janë bërë për të, dhe pastaj të krijojnë një nen të integruar. Kur të vijmë në komision, të kemi përballë nismëtarët dhe të diskutojmë për nenin e integruar.

Duke pasur parasysh kalendarin e punës, mendoj që nesër të fillojmë me Akademinë e Shkencave.

Fatjona Dhimitri – Edhe këshilltarët juridikë të grupit tonë parlamentar dhe të opozitës janë duke punuar, pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Ministrave, gjithashtu edhe ne jemi duke propozuar amendamentet tona për projektligjin. Në ditët në vijim do të kemi një përgjigje specifike se si do të veprojmë më tej.

Milva Ekonomi – A do të fillojmë nesër me ndonjë dëgjese për projektligjin? Pavarësisht nga puna me dëgjesat, i kemi lajmëruar, prandaj është mirë që nesër të thërrasim Akademinë e Shkencave ose edhe atë të Albanologjisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, të fillojmë dëgjesat me akademikët e Akademisë së Shkencave dhe akademikët e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe pastaj me universitetet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Të lutem, Muhamet, na jep pak kalendarin e punës që të shohim se cilin institucion kemi të parin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fadil Nasufi – Unë mendoj se kryetarja, nënkryetarja dhe sekretari të bëjnë draftin e dëgjësave për ligjin e akademisë dhe brenda seancës së fundit të muajit korrik ky ligj të kalojë në parlament. Ne jemi dakord.

E dyta, a ta hedhim në votim projektligjinligjin “Për rininë” që të shtyhet në parim?

Fatjona Dhimitri – Nuk mund të kalojë kaq shpejt ligji për akademinë, sepse nuk mund të zhvillohen dëgjësat brenda një dite dhe të kalojë në parlament...

Fadil Nasufi – Nuk po them të kalojë për një ditë, por ta bëni ju draftin dhe ta përcillni në kalendar, pra të caktohen datat për nesër, të mërkurën, të premten, të hënën tjetër e të tjera me radhë.

Fatjona Dhimitri – Nuk është kaq e thjeshtë, sepse edhe përgjigjja e kthyer nga Këshilli i Ministrave ka problematikat e veta, të cilat jemi duke i shqyrtuar.

Milva Ekonomi – Ke të drejtë, sepse të gjitha hidhen në votim.

Për ligjin “Për rininë”, gjëja më e rëndësishme është të presim përgjigjen e Komisionit të Ligjeve dhe pastaj ta hedhim në votim, ndërsa projektligjet e tjera i hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatjona Dhimitri – Ne jemi duke punuar, opozita është duke punuar, nëse nuk je i informuar merr informacion. Ne jemi duke punuar me grupin tonë dhe, lidhur me amendamentet, do t’i paraqesim në ditët në vijim.

Po, zoti Ismet.

Ismet Beqiraj – Si relator i këtij projektligji, jam dakord me mendimin e nënkryetares, si dhe propozimin e kolegut Nasufi, që ne kemi një kalendar të miratuar. Kushdo që ka amendamente, qoftë deputet individual, qoftë deputet që përfaqëson një grup, ka të drejtë që t’i paraqesë jo vetëm gjatë diskutimit nën për nën në komision, por edhe në seancë parlamentare. Kjo çështje nuk ka pse të jetë pengesë për të filluar diskutimin e dëgjësave, ndaj ne tani kemi një kalendar të miratuar dhe nuk do të presim më, sepse, tek e fundit, cili është produkti ligjor i komisionit në këtë sesion parlamentar?

Fatjona Dhimitri – Zoti Ismet, ju lutem, me aq sa di unë...

Ismet Beqiraj – Ju lutem, mos ndërhyini!

Fatjona Dhimitri – Me sa di unë, dëgjësat u ndërprejnë në pritje të përgjigjes së Këshillit të Ministrave.

Ismet Beqiraj – Përgjigjja zyrtare e Këshillit të Ministrave ...

Fatjona Dhimitri – Ne jemi duke shqyrtuar ...

Ismet Beqiraj – Ju lutem, zonja kryetare, mos debatoni!

Unë do të jap mendimin tim. Më pas ju mund ta kundërshtoi.

Përgjigjja ka ardhur dhe ne tani mund të fillojmë me dëgjesat, sepse nuk kemi më kohë. Cili është produkti ligjor dhe kontributi i këtij komisioni?

Fatjona Dhimitri – Besoj se ditën e mërkurë do të fillojmë me dëgjesat.

Ismet Beqiraj – Unë propozoj të fillojmë nesër me dëgjesat.

Fatjona Dhimitri – Kështu mendoj unë.

Për këtë kërkoj edhe mirëkuptimin tuaj.

Milva Ekonomi – Nuk është çështja nëse besoni ju, sepse kjo do të votohet.

Fatjona Dhimitri – Përderisa thashë: “kërkoj mirëkuptimin tuaj”, kisha parasysh votimin.

Milva Ekonomi – Problemi nuk është se dëgjesat duhen bërë shpejt për të bërë ndryshimet. Dëgjesat nuk kanë lidhje me ndryshimet që bëhen, sepse janë procese më vete.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Hedhja e ndryshimeve në diskutimin nen për nen është një proces më vete. Po nuk i dëgjuam, nuk i bëjmë dot. Ne mund të bëjmë dëgjesat dhe, ndërkohë, punohet për të parë ndryshimet që do të bëjë opozita.

Fatjona Dhimitri – Të shikojmë çfarë do të bëjmë nesër.

Milva Ekonomi – Nesër ne do të marrim vendim për ligjin “Për rininë”, që është i thjeshtë; do të lexojmë projektligjin dhe do të vendosim, pra do ta kemi ditën më të lirë. Mendoj që nesër të bëjmë dy dëgjesa me akademitë, sepse pak a shumë janë njësoj. Mund të lajmërohet Akademia e Shkencave dhe Studimet Albanologjike. Kështu do të mbarojmë me grupin e akademikëve dhe do të ngelen për dëgjesë grupi i universiteteve dhe grupi i të pavarurve. Si mendoni?

Ismet Beqiraj – Unë sërish këmbëngul që, meqenëse ky projektligj duhet mbyllur, sepse ka filluar diskutimi në parim që prej 1 muaj e gjysmë, nesër të bëjmë dëgjesa edhe me grupe të tjera interesi, që kanë bërë kërkesë. Muhameti e ka të qartë listimin. Paradite dhe pasdite të vazhdojmë me dëgjesa. Këtë javë, dy ditë para seancës, ne duhet t’i mbylлим dëgjesat. Ne kemi kaluar ligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” në një kohë rekord, me shumë dëgjesa dhe individë të caktuar, ndaj nuk kemi pse ta zgjasim. Fillimin e javës tjetër të merremi me diskutimet nen për nen dhe paraqitjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, është koeficient vështirësie plus.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – A mund të ftojme Dhimitër Haxhimihalin nesër?

Milva Ekonomi – Jo, do të fillojmë me akademitë.

Fatjona Dhimitri – Po, me akademikët.

Milva Ekonomi – Nesër do të ftojmë akademikët, pasnesër të pavarurit dhe pasdite rektorët.

Fatjona Dhimitri – Si mendoni, me cilët akademikë mund ta nisim nesër?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nesër do të fillojmë me akademikët?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po e diskutojmë.

Milva Ekonomi – Nesër, në orën 10:00, behuni gati për mbledhje komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni!

Bujar Çela – Akademikët janë të gjithë të interesuar, sepse me këtë relator që kemi ne, ligji është zgjatur pa fund. Mendoj të bëjmë një seancë dëgjimore në orën 15:00 sot.

Fatjona Dhimitri – Sot nuk kemi kohë në dispozicion për seancë dëgjimore. Propozimi juaj rrëzohet.

Milva Ekonomi – Nesër në orën 10:00 behuni gati për mbledhje komisioni. Do ta vendosim ne të tre se cilin do të ftojmë dhe do t'ju lajmërojmë.

MBYLLET MBLEDHJA